



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2018:066294

Datë: 27.01.2022

Numri i dokumentit: 02651275

Pml.nr.1/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Mejreme Memaj, anëtare të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit L.K. nga fshati K., komuna e M., për shkak të veprës penale uzurpim i pa ligjshëm i pronës së paluajtshme në vazhdimësi nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur nga mbrojtësja e të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega Malishevë P.nr.200/2018 datë 15.06.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.983/2021 datë 08.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19 janar 2022, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtëses së të dënuarit L.K., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega Malishevë P.nr.200/2018 datë 15.06.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.983/2021 datë 08.11.202 dhe çështja i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega Malishevë P.nr.200/2018 të datës 15.06.2021, i dënuari L.K. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale uzurpim i pa ligjshëm i pronës së paluajtshme në vazhdimësi nga neni 332 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht ashtu që të dënuarin e ka gjykuar me dënim me burgim në

kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënimi nuk do të ekzekutohet nëse në afatin kohor prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit i dënuari nuk kryen vepër të re penale. I dënuari është obliguar që në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit t'i liron ngastrat kadastrale nr..., .., dhe .. në vendin e quajtur "S. te K.", ZK. K., duke e njoftuar se nëse lirimi i pronës nuk bëhet në mënyrë vullnetare atëherë do të bëhet në mënyrë të dhunshëm.

I dëmtuari, B.K., lidhur me kërkesën pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. I dënuari është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor ta paguaj shumën prej 30 €, ndërsa në emër të Fondit për Kompensim të Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.983/2021 e datës 08.11.2022, ka refuzuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit kurse aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit avokatja, Bahrije Xhuliqi, nga Malisheva, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje si dhe të ndërpritet dhe të shtyhet ekzekutimi i aktgjykimit të plotfuqishëm.

Prokurori i Shteti të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr.1/2022 e datës 12.01.2022, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ushtruar nga mbrojtësja e të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, dhe pasi vlerësoi pretendimet që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësja e të dënuarit, avokatja Bahrije Xhuliqi, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384. par.1 nënpar.1.12 të KPPK, e të cilat shkelje konsistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe se nga ky dispozitivi rrjedh se i dënuari ka uzurpuar pronën e pa luajtshme e të dëmtuarit B.K. i cili është pronar i biznesit N.N.P "M.-C." SHPK, B., me seli në K., edhe pse në vitin 2012 i dëmtuari pronat kontestuese i kishte marr me koncesion nga KK. Malishevë dhe gjykata e shkallës së parë e ka obliguar të dënuarin që t'i liroi ngastrat të cilat sipas dispozitivit janë të pronësi të Kuvendit Komunal. Për më tepër gjykata e shkallës së parë e shpallë uzurpator të ngastrave kadastrale ..., .., dhe ... në vendin e quajtur "S. te K." ZK K., edhe pse i dënuari nuk ka mbajtur në shfrytëzim dhe posedim këtu ngastra me përjashtim të ngastrës ..., ku është i ndërtuar objekti, ndërsa në anën tjetër të dëmtuarit i ka skaduar kontrata për shfrytëzim

të tyre që nga viti 2016. Të gjitha këto e bëjnë që dispozitivi të jetë i paqartë dhe në kundërshtim me vetveten dhe provat e administruara në shqyrtim dhe njëkohësisht me shpalljen e të dënuarit fajtor është shkel ligji penal të të njëjtit.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe duke u bazuar shkresat e çështjes gjen se i dënuari L.K. që nga viti 2000 është i vendosur në objekt, pronë e organizatës “M.” dhe se pëlqimi i është dhënë bashkëshortes së tij e cila është punëtore e kësaj organizate. Sipas shkresës së Kuvendit Komunal të Malishevës nr.06/74/2021 datë 15.02.2021, rrjedhë se objekti në të cilin është i vendosur i dënuari L.K., gjendet në ngastrën kadastrale ..., ndërsa ngastrat kadastrale për të cilat është obliguar i njëjti t’i liroi, pra ngastra ..., ..., ... dhe ... evidentohen si pasuri shoqërore, pasuri në emër të T.Zh.R., D.R.R. Po ashtu, kjo gjykatë nga shkresat e çështjes gjen se të dëmtuarit B.K., me kontratën numër ./.... datë 18.12.2008,i janë dhënë me koncesion, nga Komuna e Malishevës ngastrat kadastrale nr....., ..., ..., ... dhe ... për ndërtim të objekteve banesore.

Gjykata Supreme e Kosovës pas vlerësimit të pretendimeve gjen se me të drejtë pretendon mbrojtësja e të dënuarit se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë me vetveten dhe me provat e administruara, nga se edhe pse në dispozitiv ceket se i dënuari që nga viti 2008 e gjer më tani, në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrare ka uzurpuar pronën e pa luajtshme të personit tjetër, konkretisht ngastrat nr....., ..., ..., ... dhe ..., nga provat e administruara vërtetohet se i dënuari shfrytëzon vetëm ngastrën ... respektivisht një pjesë të saj dhe me të njëjtin aktgjykim obligohet që t’ia liroj të gjitha këto prona. Po ashtu, nga provat vërtetohet se të dëmtuarit i ka skaduar kontrata në vitin 2016 dhe nuk është e qartë se kush është tani pronar dhe shfrytëzues i këtyre ngastrave.

Të gjitha këto e bëjnë dispozitivin të pa kuptueshëm dhe të paqartë si dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë në aktgjykim të shkallës së parë e i cili aktgjykim është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Andaj, kjo gjykatë, konstatoi se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje e kushtëzojnë anulimin e të dy aktgjyqimeve.

Në rishqyrtim gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanoj të gjitha vërejtjet e cekura më lartë, së pari të qartësoj faktin se cilën ngastër e shfrytëzon i dënuari dhe faktin se a e gëzon të drejtën e shfrytëzimit tani i dëmtuari, dhe pasi që ti vërtetoj të gjitha këto fakte si dhe pasi që t’i administroj dhe vlerësoj të gjitha provat një nga një, të merr një vendim meritore në këtë çështje penale.

Nga të gjitha këto që u tha më lart, e konform dispozitës së nenit 438 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Pml.nr.1/2022, më 19 janar 2022

Numri i lëndës: 2018:066294
Datë: 27.01.2022
Numri i dokumentit: 02651275

Procesmbajtësi,
Sherfi Krasniqi

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi